




PROKURORIA E SHTETIT KOORDINON HETIMET PËR MANIPULIMET ME VOTA NË ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT

I FAQE 4-5



Trajtimi i rasteve që lidhen me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës ishte temë diskutimi në takim të kolegjiut të u. d. Kryeprokurorit të Shtetit me kryeprokurorët e prokurorive. Në këtë takim, i cili u mbajt të mërkurën, u kërkuar nga të gjithë kryeprokurorët që rastet e ndërlidhura me këtë proces zgjedhor të trajtohen me prioritet, konkretisht rastet e keqpërdorimit dhe falsifikimit të votës, me qëllim të trajtimit sa më efikas të të gjitha rasteve në nivel vendi

**LËMOSHË
APO REFORMË
SOCIALE: ÇFARË
PËRFITON REALISHT
QYTETARI
I KOSOVËS?** F. 5



**VISOKA:
BORDI I PAQES
MUND T'I
SJELLË KOSOVËS
PËRFITIME NË
POLITIKËN E
JASHTME** F. 5



AKTUALE



**LUFTANIJET AMERIKANE ARRIJNË
NË LINDJEN E MESME, TRUMPI
THOTË SE IRANI DËSHIRON
TË BISEDOJË** F. 2

**RAMA PEZULLON NGA PUNA TË TRE
ZYRTARËT KOMUNALË QË U
ARRESTUAN PËR RYSHFET** F. 3

**AKTORI EDI KASTRATI DHE TEATRI
"HADI SHEHU" NË GJAKOVË
NË MBËSHETJE TË MARSHIT
"DREJTËSI, JO POLITIKË"
MË 17 SHKURT** F. 7

EKONOMI



**KOSOVA DHE SERBIA
S'PËRFITOJNË NGA 171 MILIONË
EUROT QË BE-ja NDAN
PËR BALLKANIN** F. 8

SPORT



**NË PRAG TË SHORTIT TË LIGËS SË
KOMBEVE, UEFA TREGON SE KOSOVËS
I NDALOHET TË LUAJË KUNDËR
BOSNJË-HERCEGOVINËS** F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

KUSHTETUESJA: ZGJEDHJA E RASHIQIT NËNKRYETAR I KUVENDIT ISHTE ANTIKUSHTETUESE

PRISHTINË, 28 JANAR - Gjykata Kushtetuese e Kosovës vendosi që zgjedhja e Nenad Rashiqit në pozitën e nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb në legjislaturën e kaluar nuk

ishite në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit. Në njoftimin për aktgjykimin, Gjykata tha më 28 janar se ky “në rrethanat e rastit konkret nuk ka efekt

prapaveprues”. Rashiqi u zgjodh në tetorin e vitit të kaluar, pasi të propozuarit nga Lista Serbe - që kishte nëntë deputetë - nuk morën votat e nevojshme dhe u organizua

shorti. Kushtetuesja tha se e drejta për ta propozuar nënkryetarin nga radhët e komunitetit serb i takon shumicës së deputetëve të këtij minoritet.



BE-ja DHE INDIA ARRIJNË MARRËVESHJE TREGTARE

BRUKSEL, 28 JANAR - Bashkimi Evropian dhe India njoftuan për arritjen e asaj që po konsiderohet si marrëveshja më e madhe tregtare - pakt që krijon një treg për dy miliardë njerëz, i cili u arrit pas dy dekadash negociata. Shefat e BE-së dhe kryeministri i Indisë, Narendra Modi, thanë se shpresojnë që marrëveshja do të ndihmojë në mbrojtjen ndaj sfidave që vijnë nga dy ekonomitë kryesore të botës, Shtetet e Bashkuara dhe Kina. Marrëveshja do të ulë ose eliminojë tarifatat për pothuajse 97 për qind të eksporteve evropiane, duke kursyer deri në 4 miliardë euro në vit nga detyrimet doganore, njoftoi blloku evropian prej 27 shtetesh. “Nëna e të gjitha marrëveshjeve”, tha Modi në Nju-Deli, kur u takua të martën me presidenten e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, dhe presidentin e Këshillit Evropian, Antonio Costa. “Kjo marrëveshje do të sjellë shumë mundësi për 1.4 miliard banorët e Indisë dhe



për miliona njerëz në BE”, tha Modi, duke shtuar se marrëveshja “paraqet rreth 25 për qind të GDP-së globale dhe një të tretën e tregtisë globale”. BE-ja e ka parë Indinë - vendin më të populluar në botë - si një treg të rëndësishëm për të ardhmen. “Evropa dhe India po bëjnë histori sot”, tha von der Leyen përmes një deklarate. “Kemi krijuar një zonë të tregtisë së lirë me 2 miliardë njerëz, nga e cila do të përfitojnë të dyja palët”. Zyrtarët e BE-së thanë se

marrëveshja ishte më ambiciozja që India ka pranuar ndonjëherë, dhe se kompanitë evropiane do të përfitojnë nga i ashtuquajti “avantazh i hyrjes në treg si të parët”. Sektorët kryesorë evropianë të bujqësisë, industrisë automobilistike dhe shërbimeve pritet të përfitojnë nga marrëveshja. Megjithatë, sektorët e ndjeshëm bujqësorë, si ai i mishit të viçit, orizit dhe sheqerit - përfshirja e të cilave në një marrëveshje të mëhershme mes bllokut evropian dhe Amerikës së

Jugut, Mercosur, nxiti zemërim në mesin e fermerëve evropianë - u lanë jashtë kësaj marrëveshjeje. Nju-Delhi e sheh bllokun evropian si një burim të rëndësishëm të teknologjisë dhe investimeve shumë të nevojshme për të rritur infrastrukturën e saj dhe për të krijuar miliona vende të reja pune. Marrëveshja përfshin gjithashtu një partneritet në fushën e sigurisë, duke ofruar “mundësi të reja” për kompanitë e mbrojtjes, tha Modi. Tregtia dypalëshe e mallrave mes BE-së dhe Indisë arriti në 120 miliardë euro në vitin 2024, një rritje prej gati 90 për qind gjatë dekadës së fundit, sipas të dhënave të BE-së, ndërsa edhe 60 miliardë euro të tjera ishin në tregtinë e shërbimeve. Sipas bllokut, në kuadër të marrëveshjes, India pritet të lehtësojë qasjen në treg, ndërsa kompanitë evropiane do të kenë qasje të privilegjuar në tregun e Indisë për shërbime financiare dhe të transportit detar.

Tarifatat për makinat do të ulen gradualisht nga niveli maksimal prej 110-përqindësh në deri në 10 për qind, ndërsa tarifatat për verërat do të bien në mënyrë progresive nga 150 për qind në deri në 20 për qind. Sipas BE-së, tarifatat aktuale prej 50-përqindësh për ushqimet e përpunuara - përfshirë makaronat dhe çokollatën - do të hiqen plotësisht. Marrëveshja vjen në kohën kur Brukseli dhe Nju-Deli po synojnë të hapen ndaj tregjeve të reja në dritë të tarifave amerikane dhe kontrolleve të vendosura nga Kina për eksportet. India pritet të bëhet ekonomia e katërt më e madhe në botë gjatë këtij viti, sipas parashikimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Nju-Delhi, që për dekada është mbështetur te Moska për pajisje kryesore ushtarake, vitet e fundit është përpjekur ta ulë varësinë nga Rusia duke diversifikuar importet dhe duke nxitur prodhimin e vet vendas. Evropa po bën të njëjtën gjë sa i përket Shteteve të Bashkuara.

LUFTANIJET AMERIKANE ARRIJNË NË LINDJEN E MESME, TRUMPI THOTË SE IRANI DËSHIRON TË BISEDONJË

UASHINGTON, 28 JANAR - Një grup aeroplanmbajtësish amerikanë kanë arritur në Lindjen e Mesme më 27 janar, ndërsa tensionet po rriten lidhur me një sulm të mundshëm ndaj Iranit, pas një shtypjeje brutale të protestave, që sipas grupeve për të drejtat e njeriut kanë lënë të vrarë mijëra persona. Në mes të trazirave, valuta iraniane, riali, ra në nivelin më të ulët kundrejt dollarit, duke u këmbyer me 1.5 milion rialë më 27 janar. Presidenti amerikan, Donald Trump, tha se “shpreson” që të mos ketë nevojë për veprim ushtarak ndaj Iranit, por ai po ashtu ka dërguar një “flotë” në rajon, duke refuzuar që të heqë

nga opsionet sulmet ajrore si përgjigje ndaj shtypjes së protestuesve, kryesisht paqësorë, të cilët dolën në rrugë javët e fundit për të kërkuar veprime për të ndaluar inflacionin dhe zhvlerësimin e valutës. Organizata për të drejtat e njeriut me seli në ShBA, HRANA, shifrat e së cilës Radio Evropa e Lirë i ka cituar rregullisht që nga fillimi i shtypjes së dhunshme të protestave në Iran, thotë se numri i konfirmuar i të vdekurve, përfshirë të forcave të sigurisë, tani ka arritur në 6.126, ndërsa numri i viktimave që ende po hetohen është 17 091. Disa vlerësime nga zyrtarë të

cituar jozyrtarisht nga media të ndryshme janë disa herë më të larta. Presidenti amerikan Donald Trump tha për Axios në një intervistë më 26 janar se situata me Iranin “po ndryshon” sepse ai ka dërguar një “flotë të madhe” në rajon, me një grup sulmues të udhëhequr nga aeroplanmbajtësi USS Abraham Lincoln, tashmë në ujërat e Lindjes së Mesme, sipas Komandës Qendrore të ShBA-së. Por, Trump shtoi se mendon që Teherani vërtet dëshiron të arrijë një marrëveshje. “Ata duan të arrijnë një marrëveshje. Na kanë thirrur në disa raste. Ata duan të flasin”, citohet të ketë



thënë Trump. Protestat nisën më 28 dhjetor në tregjet e kryeqytetit iranian, Teheran, mes zemërimit të tregtarëve për kushtet e rënda ekonomike. Demonstratat u

përhapën me shpejtësi në mbarë shtetin dhe u shndërruan në protesta kundër autoriteteve për shkak të përkeqësimit të standardit të jetesës dhe shtypjes së lirisë.

PROKURORIA E SHTETIT KOORDINON HETIMET PËR MANIPULIMET ME VOTA NË ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT



Trajtimi i rasteve që lidhen me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës ishte temë diskutimi në takimin e kolegjiut të u. d. Kryeprokurorit të Shtetit me kryeprokurorët e prokurorive. Në këtë takim, i cili u mbajt të mërkurën, u kërkua nga të gjithë kryeprokurorët që rastet e ndërlidhura me këtë proces zgjedhor të trajtohen me prioritet, konkretisht rastet e keqpërdorimit dhe falsifikimit të votës, me qëllim të trajtimit sa më efikas të të gjitha rasteve në nivel vendi

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 28 JANAR - Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Agron Qalaj, ka mbajtur të mërkurën kolegjiut të rregullt me të gjithë kryeprokurorët dhe përfaqësuesit e prokurorive, si dhe me prokurorë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit. Gjatë këtij takimi u diskutua lidhur me trajtimin nga ana e prokurorëve të shtetit për rastet që ndërlidhen me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025. Me këtë rast u. d. Kryeprokurori i Shtetit, Agron Qalaj, ka

vlerësuar angazhimin e të gjithë prokurorëve, duke theksuar se gjatë procesit zgjedhor, prokuroritë kanë vepruar me vigjilencë dhe profesionalizëm, në përputhje me kompetencat ligjore, me qëllim të garantimit të integritetit të procesit zgjedhor dhe mbrojtjes së vullnetit të qytetarëve të shprehur me votë. Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje, prokurorja Laura Pula ka informuar të pranishmit për koordinimin ndërmjet prokurorive dhe Koordinatores Nacionale lidhur me aktivitetet e ndërmarrë nga të gjitha prokuroritë themelore në rastet kur është evidentuar ose dyshuar për cenim të procesit

zgjedhor, konkretisht në rastet kur është keqpërdorur - falsifikuar vota. Edhe kryeprokurorët e të gjitha prokurorive themelore informuan për veprimet konkrete të ndërmarrë në hetimet e zhvilluara lidhur me këto raste, konkretisht për grumbullimin e informatave dhe sigurimin e provave relevante, lidhur me dyshimet për manipulim të votave për kandidatët për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në fund të takimit, u. d. kryeprokurori Qalaj kërkoi nga të gjithë kryeprokurorët unifikimin e veprimeve dhe praktikave hetimore nga të

gjitha prokuroritë në trajtimin e rasteve që ndërlidhen me këtë proces zgjedhor, konkretisht në rastet kur është keqpërdorur - falsifikuar vota, me qëllim të trajtimit në mënyrë sa më efikase të të gjitha rasteve në nivel vendi.

Aksioni në Malishevë: 15 kryesues të ndaluar nën dyshimet për manipulime të votave

Ndaj 15 kryesuesve zgjedhorë në Komunën e Malishevës është caktuar masa e ndalimit prej 48-orësh, pas aksionit të së mërkurës në këtë komunë

lidhur me dyshimet për manipulime të votave të kandidatëve për deputetë për zgjedhjet e 28 dhjetorit.

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Enis Gashi, tha se gjatë aksionit cak ishin 18 kryesues dhe 50 komisionarë. Ai tha se u intervistuan 15 kryesues, që u dërguan në ndalim dhe 43 komisionarë. Për komisionarët tha se do të vendoset nëse do të ndërmerret ndonjë masë sigurie. Megjithatë, në hetimet e deritanishme për manipulim të votave, të dyshuar që janë marrë në pyetje kanë qenë komisionarë dhe vëzhgues që kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejt në numërimin e votave.

Rinumërimi në Malishevë, komunë në pjesën qendrore të vendit ka përfunduar tashmë dhe ai tregon një dallim në votat për kandidatët për deputetë. Të paktën tre kandidatëve të Partisë Demokratike të Kosovës u janë hequr nga mbi 700 votat secilit në këtë komunë.

Edhe kandidatëve nga partitë e tjera si ajo në pushtet Lëvizja Vetëvendosje, Nisma, Lidhja Demokratike dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, u janë hequr vota pas rinumërimit në këtë komunë, por në numër diçka më të vogël.

Ky operacion është i dyti i këtij lloji si pjesë e një hetimi të gjerë për manipulim të votave në zgjedhjet e fundit të parakohshme të Kosovës.

Një operacion i ngjashëm u krye javën e kaluar në Prizren, ku u arrestuan 109 të dyshuar, prej të cilave 23 u dërguan në paraburgim nën dyshimin se kishin manipuluar vota të kandidatëve për deputetë.

Dyshimet për manipulim të votave të zgjedhjeve të dhjetorit kanë hedhur dyshime serioze mbi procesin zgjedhor, dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u detyrua ta bëjë rinumërimin e plotë të votave, pasi kishte gjetur mospërputhje të mëdha në votat për kandidatët për deputetë.

Komisioni bëri të ditur të martën se pret ta përfundojë rinumërimin në fundjavë, pasi tashmë janë rinumëruar mbi 80 për qind e votave.


Rama pezullon nga puna të tre zyrtarët komunalë që u arrestuan për ryshfet

PRISHTINË, 28 JANAR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka pezulluar nga puna të tre zyrtarëve komunalë, pas arrestimit të tyre si të dyshuar për ryshfet. "Pezullimi nga puna do të jetë në fuqi deri në përfundimin e procedurave hetimore dhe

gjyqësore, ndërkohë që Kryeqyteti rritet për kushtetimin për ligjshmëri, transparencë dhe zero tolerancë ndaj korrupsionit. Institucioni i Kryeqytetit do të bashkëpunojë plotësisht me organet e drejtësisë dhe do të ndërmarrë të gjitha veprimet

e nevojshme administrative në përputhje me ligjin. Kryeqyteti mbetet i përkushtuar që shërbimet publike të ushtrohen me integritet dhe përgjegjësi në shërbim të qytetarëve. Askush mbi ligjin!", ka shkruar Rama në "Facebook".





LËMOSHË APO REFORMË SOCIALE: ÇFARË PËRFITON REALISHT QYTETARI I KOSOVËS?

Ndihmat e njehershme lehtësojnë krizën, por efekti i tyre afatgjatë mbetet i diskutueshëm. Masat universale nuk targetojnë mjaftueshëm familjet më në nevojë, sipas ekspertëve. Sistemet më të konsoliduara, si në Danimarkë dhe ShBA, ofrojnë mbështetje sociale të qëndrueshme dhe të strukturuar

PRISHTINË, 28 JANAR - Nga arka e buxhetit shtetëror të Kosovës, nga 100 euro tashmë kanë përfunduar në llogaritë e dhjetëra mijëra studentëve. Në vitet e fundit Qeveria e Kosovës ka shpërndarë një varg ndihmash të tilla financiare për kategori të ndryshme të shoqërisë - nga familjet me fëmijë e lehonat, te studentët e pensionistët. Këto masa janë paraqitur si përgjigje ndaj krizave të njëpasnjëshme, si pandemia Covid-19 e inflacioni, dhe si dhurata për fundvit e fillim të vitit shkollor. Por, pyetjet se çfarë efekti real kanë pasur ato dhe nëse po çojnë drejt një reforme më të gjerë të sistemit të mirëqenies sociale, mbeten të hapura. Radio Evropa e Lirë e ka pyetur Qeverinë e Kosovës nëse ka bërë matje të efektit të këtyre ndihmave dhe nëse është menduar që ato të shndërrohen në reforma më të

gjera të sistemit të mirëqenies sociale, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk ka marrë përgjigje. Sipas Visar Ymerit, drejtues i Institutit "Musine Kokalari" për çështje sociale, problemi nuk është vetë ekzistenca e ndihmave, por mënyra se si ato janë konceptuar. "Shtesat e njehershme mund ta lehtësojnë një moment krize, por nuk e ndryshojnë realisht pozitën ekonomike të familjeve", thotë Ymeri për Radion Evropa e Lirë. Ai thekson se pa një vizion transformues, këto masa mbesin më shumë gjeeste politike sesa politika sociale. "Në një vend demokratik, politikatat sociale duhet të diskutohen nga perspektiva afatgjate. Nga njëra anë, ato shërbejnë për të zbutur vështirësitë momentale, por, nga ana tjetër, duhet të kenë një qasje transformuese", shton Ymeri.

Në fund të vitit të kaluar, kur Qeveria e Kosovës ka ndarë nga 100 euro për të moshuarit dhe fëmijët, vendimi është kritikuar se përkonte me kohën e fushatës për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Edhe gjatë fushatës për zgjedhjet lokale vitin e kaluar, qeveria e udhëhequr nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti, është kritikuar se ndarja e shtesave të ngjashme për studentë, është bërë me qëllim të "blerjes së votave". Të dyja këto vendime janë arsyetuar nga qeveria e udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje - partia e vetme e madhe në Kosovë që i takon krahut të majtë politik - duke u thënë se janë bërë edhe në vitet paraprake, kur nuk ka pasur fushatë elektorale. Një pjesë e madhe e ndihmave është shpërndarë përmes shtesave për lehona dhe për fëmijë. Qeveria i ka paraqitur këto masa si investim në familje dhe në mirëqenien e fëmijëve. Edhe pse Ymeri, ish-kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje e tani drejtor ekzekutiv në "Musine Kokalari", në parim e përkrah idenë, ai mbetet i pakënaqur nga mosbërja e dallimit mes familjeve që janë në nevojë të thellë dhe atyre që kanë të

ardhura më të qëndrueshme. Sipas Ymerit, politikatat universale mund ta kenë përparësi thjeshtësinë e zbatimit, por rrezikojnë ta humbin efektin aty ku nevoja është më e madhe. "Familjet me të ardhura të ulëta dhe mesatare, që nuk arrijnë të përballojnë shpenzimet bazë, si: energjia, ushqimi dhe edukimi i fëmijëve, duhet të trajtohen ndryshe. Megjithatë, qeveria ka zgjedhur masën e sheshtë, e cila i ka anët e veta pozitive, për shkak të thjeshtësisë, por edhe anët negative, sepse nuk i targeton mjaftueshëm ata që janë më në nevojë", shpjegon Ymeri. Gjatë kësaj periudhe ndihmat financiare kanë përfshirë edhe studentët të cilëve u janë ndarë pagesa të njehershme ose mbështetje për përballimin e kostove të jetesës dhe studimeve në fillim të vitit akademik. Po ashtu, janë rritur pensionet dhe paga minimale si pjesë e përpjekjeve për të zbutur goditjen e inflacionit. Megjithatë, sipas Ymerit, rritjet nuk kanë qenë të mjaftueshme për ta ruajtur fuqinë blerëse të qytetarëve, sidomos në kushtet e rritjes së vazhdueshme të çmimeve të ushqimit dhe energjisë.

Ai thotë se mungesa e analizave publike, e bën të vështirë vlerësimin e ndikimit real të këtyre masave. "Ne nuk e dimë nëse këto transfere financiare e kanë ulur varfërinë, nëse e kanë zbutur pabarazinë apo nëse, thjesht, e kanë shtyrë problemin për disa muaj", thotë Ymeri. Ai thekson se futja e parave në treg, pa një plan të qartë, mund të ketë edhe efekte inflacioniste, duke e neutralizuar në fakt përfitimin për qytetarët. Kosova me mbi 1.5 milion banorë, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave (ASK), ka 15 skema sociale e pensionale, nga të cilat përfitojnë qindra-mijëra qytetarë. Sipas një publikimi të Bankës Botërore në prill të vitit të kaluar, shkalla e varfërisë vlerësohet të ketë qenë rreth 19.5 për qind në vitin 2023. Në fund të dhjetorit të vitit të kaluar vetë ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka treguar se është rritur numri i "familjeve të cenueshme" që përfitojnë nga subvencionet e energjisë elektrike për rreth 25 për qind. Subvencionimi i energjisë elektrike është një program që synon t'i ndihmojë familjet me

VISOKA: BORDI I PAQES MUND T'I SJELLË KOSOVËS PËRFITIME NË POLITIKËN E JASHTME

Profesori i studimeve për paqe dhe konflikt në Universitetin e Dublinit në Irlandë, Gëzim Visoka, ka thënë se pjesëmarrja e Kosovës në Bordin e Paqes, nismë e iniciuar nga presidenti amerikan Donald Trump, mund t'i sjellë vendit përfitime të rëndësishme në politikën e jashtme, pavarësisht kostove të mundshme. Ai thotë se për sa kohë Kosova mbetet jashtë organizatave të mëdha ndërkombëtare si NATO-ja, Bashkimi Evropian dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara, nisma të tilla mund t'i shërbejnë forcimit të pozicionit të saj diplomatik

PRISHTINË, 28 JANAR - Pjesëmarrja e Kosovës në Bordin e Paqes, nismë e iniciuar nga presidenti amerikan Donald Trump, mund t'i sjellë vendit përfitime të rëndësishme në politikën e jashtme pavarësisht prej kostove të mundshme, vlerëson profesori i studimeve për paqe dhe konflikt në Universitetin e Dublinit në Irlandë, Gëzim Visoka. Në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, Visoka thotë se për sa kohë Kosova mbetet jashtë organizatave të mëdha ndërkombëtare si NATO-ja, Bashkimi Evropian dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara, nisma të tilla mund t'i shërbejnë forcimit të pozicionit të saj diplomatik. "Kjo platformë mund t'i ofrojë Kosovës një hapësirë për lobim dhe të kërkojë njohje të reja nga shtete si Maroku apo vende të tjera që ende nuk e

kanë njohur Kosovën... Deri më tani sistemi i OKB-së nuk i ka ofruar Kosovës barazi, qasje të duhur, nuk ka qenë në shërbim të së drejtës së Kosovës për vetëvendosje, për anëtarësim në sistemin ndërkombëtar dhe për njohje ndërkombëtare. Në një farë mënyre, kjo është edhe një protestë ndaj rendit të OKB-së, i cili ka përfunduar duke u bërë vegël e fuqive të mëdha", thotë Visoka. Kosova iu përgjigj pozitivisht ftesës së presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, duke nënshkruar Kartën e Bordit të Paqes si anëtare themeluese më 22 janar në Davos të Zvicrës. Gjatë fjalimit hapës në Davos, Trumpi tha se do të punojnë me shumë të tjerë, përfshirë edhe OKB-në. "Ky bord ka mundësinë të jetë një nga organet më me ndikim të



Kush e nënshkroi Kartën e Bordit të Paqes?

Arabia Saudite, Argjentina, Armenia, Azerbajxhani, Bahrejni, Bullgaria, Emiratet e Bashkuara Arabe, Hungaria, Indonezia, Jordania, Katari, Kazakistani, Kosova, Mongolia, Maroku, Pakistani, Paraguai, Turqia, Uzbekistani.

krijua ndonjëherë dhe është një nder i jashtëzakonshëm për mua të shërbej si kryetar i tij. Sot po shpalosen hapat e parë drejt një dite më të ndritshme për Lindjen e Mesme dhe një të ardhmeje shumë më të sigurt për botën", tha Trumpi. Sipas Visokës, ky veprim e pozicionon Kosovën qartë në krah të ShBA-së, edhe në kontekstin e raporteve të tensionuara me Bashkimin Evropian, pa e përjashtuar

orientimin euroatlantik të vendit. Ai shton se pjesëmarrja në Bordin e Paqes mund të shihet edhe si paralajmërim për BE-në se, nëse Kosova dhe rajoni vazhdojnë të mbeten anash, mund të shfaqen iniciativa të pavarura që e zbehin vizionin evropian për Ballkanin. I pyetur nëse çështja Kosovë - Serbi do të mund të zgjidhej përmes Bordit të Paqes, Visoka tha se është shfaqur interesim që kjo organizatë të ketë

mandat përtej Gazës, për të zgjidhur edhe konflikte të tjera, por se "mbetet për t'u parë sa janë të qëndrueshme këto paqebërje". Në një intervistë për transmetuesin britanik BBC të dielën, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se përvoja e Kosovës tregon se paqja arrihet përmes veprimit, duke theksuar se ShBA-ja mobilizoi botën për të ndihmuar vendin gjatë luftës, ndërsa OKB-ja, sipas saj, dha vetëm fjalë pa veprime.

të ardhura të ulëta për të përballuar fatura më të larta të energjisë, veçanërisht në muajt e dimrit kur konsumimi dhe kostoja e energjisë shpesh rriten. Ndërkohë, debati për shtesat për lehonat dhe fëmijët ka hapur edhe diskutime të tjera. Nga një perspektivë feministe, Ymeri vëren se këto politika mund të kenë pasojat të padëshiruara, nëse nuk shoqërohen me masa për integrimin e grave në tregun e punës. "Nëse mbështetja financiare nuk lidhet me politikat e punësimit, kujdesit për fëmijët dhe shërbimeve sociale, ajo mund të përforcojë role tradicionale dhe varësi afatgjatë", thotë ai. Ymeri u referohet ankesave nga organizatat e ndryshme feministe në vend, se ky lloj i shtesave mund ta përforcojë

modelin tradicional të familjes, ku kujdesi për fëmijët mbetet kryesisht barrë e grave. Sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2024, vetëm 25.9 për qind e grave në moshë pune janë aktive në tregun e punës krahasuar me 60.6 për qind të burrave. Krahasuar me Kosovën, vendet me sisteme më të konsoliduara të mirëqenies sociale e kanë ndërtuar ndihmën shtetërore si pjesë të një strukture të qëndrueshme. Në Danimarkë, për shembull, mbështetja për familjet dhe individët nuk jepet kryesisht përmes pagesave të njëhershme, por përmes një sistemi të rregullt që përfshin ndihma për fëmijë, leje prindërore, sigurim shëndetësor universal dhe shërbime publike cilësore.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sistemi është më i fragmentuar, por gjithashtu i strukturuar rreth programeve afatgjate. Pensionet dhe ndihmat për të moshuarit bazohen në kontributet e paguara gjatë jetës në punë, ndërsa familjet me të ardhura të ulëta përfitojnë nga programe të veçanta për ushqim, shëndetësi dhe strehim. Sipas Ymerit, dallimi kryesor mes këtyre vendeve dhe Kosovës qëndron te mungesa e një vizioni të qartë për të ardhmen e shtetit. "Pyetja nuk është nëse duhet të ketë ndihma, por çfarë modeli të mirëqenies duam të ndërtojmë", thotë ai. "Në përgjithësi, politikat sociale në Kosovë janë ndërtuar më shumë si reagime të momentit, sesa si pjesë e një vizioni afatgjatë transformues. Kjo

mund të çojë në disbalancë ekonomike dhe buxhetore, sepse të hyrat zvogëlohen ndërsa obligimet rriten", shton Ymeri. Për këtë ai thotë se është shumë e rëndësishme që ndihmat e ndryshme sociale të mos merren si vendime të Qeverisë së Kosovës, por të përcaktohen me ligj si të drejta që u takojnë qytetarëve. Kështu, shton ai, ndihmat s'do të shihen si barrë apo lëmoshë. Nëse lihen vetëm si vendime qeveritare, Ymeri sqaron se me ardhjen e një qeverie të re, këto ndihma mund të reshtin së ekzistuari fare lehtë. "Këto çështje nuk zgjidhen me vendime të izoluar. Nevojitet dialog me sindikatat, inspektim më i fortë i tregut të punës, rritje e kapaciteteve institucionale dhe reforma të pagave e kontratave kolektive

sipas sektorëve", thotë Ymeri. Për të zgjidhja afatgjatë më e mirë do të ishte ndërtimi i një sistemi që bazohet në tregun e punës, shërbime publike cilësore dhe skema sociale të qëndrueshme. Për këtë, ai e merr shembull sistemin në Holandë. "Mirëqenia përmes punës ruan dinjitetin njerëzor dhe zvogëlon varësinë nga skemat sociale, të cilat në çdo vend kanë edhe një dimension stigmatizues", thotë Ymeri. Megjithatë, ai shton se pa investime serioze në arsim, shëndetësi dhe punësim, shtesat financiare do të mbeten vetëm zgjidhje të përkohshme. "Pyetja kryesore mbetet: ku po i shpenzojmë paratë publike dhe a po i përdorim ato në mënyrën më të drejtë dhe më të qëndrueshme?", përfundon Ymeri.

Tërnava dënon djegien e kuranit në Gjakovë

PRISHTINË, 28 JANAR - Kryetari i Bashkësisë Islame në Kosovë, myftiu Naim Tërnava, është shprehur i tmerruar dhe i tronditur nga akti vandal dhe kriminal i djegies dhe përdhosjes së Kuranit të Shenjtë, i kryer me porosi dhe mision të qartë kriminal nga persona ende të panjohur në Çabrat të Gjakovës. “Jam thellësisht i tmerruar dhe i tronditur nga akti vandal dhe kriminal i djegies dhe

përdhosjes së Kuranit të Shenjtë, i kryer me porosi dhe mision të qartë kriminal nga persona ende të panjohur në Çabrat të Gjakovës. Një veprim i tillë është plotësisht i papranueshëm, pasi cenon rëndë vlerat universale humane të qytetërimit botëror dhe, njëkohësisht, godet drejtpërdrejt parimet, traditën dhe identitetin e popullit tonë. Populli shqiptar, ndër shekuj, është njohur dhe është

identifikuar për harmoni, bashkëjetesë dhe mirëkuptim ndërfetar, si dhe për respektimin e besimit, kulturës dhe traditës së tjetrit, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje të ndjeshme që lidhen me fenë dhe besimin”, ka thënë Tërnava, duke kërkuar nga organet kompetente shtetërore të ndërmarrin menjëherë veprimet e nevojshme ligjore ndaj autorëve të këtij akti kriminal.



KAMENICA I BASHKOHET PROJEKTIT RERURAL PËR ANGAZHIMIN DHE ZHVILLIMIN E ENERGJISË KOMUNITARE

KAMENICË, 28 JANAR - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, së bashku me drejtorin e Shërbimeve Publike, Zotrim Kastrati, kanë pritur në takim Liri Kuçi, hulumtuese e lartë në organizatën Balkan Green Foundation, si dhe Ngadhënjim Halilaj, menaxher i projekteve në këtë organizatë. Në këtë takim është diskutuar për bashkëpunimin e deritashëm me këtë organizatë si dhe për mundësitë e vazhdimin të këtij bashkëpunimi përmes projektit ReRural. I pari i komunës ka falënderuar përfaqësuesit e organizatës Balkan Green Foundation, duke theksuar se komuna është e gatshme t'i bashkojë forcat me organizata të tilla për të qenë pjesë e projekteve që synojnë mirëqenien e qytetarëve. “Ju falënderoj për angazhimin tuaj të vazhdueshëm në projektet e përbashkëta që kemi pasur. Jam i gatshëm ta konsolidojmë këtë bashkëpunim, tashmë edhe përmes projektit të ri ReRural, i cili ka për qëllim energjinë e

ripërtëritshme. Ne si komunë kemi pasur disa projekte të vogla në këtë drejtim, mirëpo shpeshherë rrethana të ndryshme kanë penguar vazhdimin e tyre. Megjithatë, me këtë projekt dhe me një organizatë si Balkan Green Foundation, besojmë se kemi gjetur projektin e duhur për Kamenicën”, ka thënë kryetari Rahimaj. Hulumtuesja Liri Kuçi, duke falënderuar kryetarin Rahimaj për bashkëpunimin e deritanishëm, theksoi rëndësinë e këtij projekti për Kamenicën, duke e parë atë si një komunë shembull për komunat e tjera. “Projekti ReRural, i financuar nga programi EUKI, synon të rrisë ndërgjegjësimin për varfërinë energjetike në zonat rurale të Evropës Juglindore, duke propozuar si zgjidhje tranzicionin energjetik dhe komunitetet energjetike. Duke marrë parasysh se Komuna e Kamenicës ka orientim të qartë drejt energjisë së ripërtëritshme, kemi vlerësuar se ky projekt



mund të sjellë rezultate shumë të mira dhe ta shndërrojë Kamenicën në një komunë shembull për të tjerat”, ka thënë ajo, duke përmendur edhe rezultatet e pritshme të projektit.

Në këtë kuadër, komuna e Kamenicës i bashkohet projektit ReRural (i financuar nga EUKI përmes Ministrisë Gjermane për Ekonomi dhe Veprim Klimatik), në partneritet me Balkan Green

Foundation, si angazhim institucional për vlerësimin e kapaciteteve komunale dhe krijimin e kushteve konkrete për themelimin dhe mbështetjen e komuniteteve energjetike.

FUNKSIONALIZOHET ZYRA E GJENDJES CIVILE NË SPITALIN RAJONAL NË MITROVICË



MITROVICË, 28 JANAR - Komuna e Mitrovicës, përmes Drejtorisë së Administratës, ka bërë të mundur funksionalizimin e shërbimeve të gjendjes civile brenda Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë. Me këtë rast, nënkryetari i komunës, Enis Osmani, së bashku me drejtorin

e Administratës, Alban Fejzullahu, të mërkurën kanë vizituar këtë zyrë për të parë nga afër shërbimet dhe kushtet që operon kjo zyrë. Për disa muaj ky shërbim kishte qenë i mbyllur, gjë që detyronte nënat lehona të vizitonin komunën për regjistrimin e

fëmijëve dhe për kryerjen e procedurave të tjera administrative. Me rikthimin e funksionimit të shërbimeve në ambientet e spitalit, qytetarët tashmë kanë mundësi më të lehtë dhe më të shpejtë për t'i kryer këto procedura pa udhëtime të panevojshme.

Lushtaku vizitë zyrtare në Libi

SKENDERAJ, 28 JANAR - Kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Libi, me ftesë të gjeneralit Feldmarshall Khalifa Belkasem Haftar. Gjatë kësaj vizite ai ka zhvilluar takime të rëndësishme dhe ka biseduar

për çështje me interes të ndërsjellë, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit, mirëkuptimit dhe forcimit të urave të komunikimit ndërmjet nesh. “Shpreh falënderimin tim të sinqertë për gjeneralin Feldmarshall Khalifa Belkasem Hifter për

organizimin e shkëlqyer dhe për pritjen e përzemërt e vëllazërore. Mikpritja dhe respekti i treguar janë dëshmi e vullnetit për marrëdhënie të mira dhe bashkëpunim të mëtejshëm!”, ka shkruar Lushtaku në “Facebook”.



PROFILI QË I TEJKALON ZGJEDHJET

Shkruan: Nazmi JUSUFI

Moszgjedhja e gjeneral Agim Çekut në Kuvendin e Kosovës në zgjedhjet e fundit nuk është një ngjarje e zakonshme politike dhe as një episod që duhet kaluar pa reflektim. Jo për shkak të ambicies së një individi, por për shkak të peshës së figurës që mbeti jashtë jetës parlamentare.

Agim Çeku nuk është thjesht një emër në një listë zgjedhore. Ai është Komandanti i Përgjithshëm i UÇK-së, arkitekt i strukturimit ushtarak të luftës çlirimtare, strateg ushtarak, ish-kryeministër i Kosovës në një nga fazat më delikate të shtetformimit dhe figurë me profil ndërkombëtar. Biografia e tij nuk është produkt i marketingut politik, por i proceseve reale historike.

Figura të tilla, në çdo vend normal, përfaqësojnë kapital shtetëror. Jo domosdoshmërisht për t'u votuar përjetësisht, por për t'u trajtuar si burim përvojë, stabiliteti dhe racionaliteti institucional.

Megjithatë, zgjedhjet nuk

maten me biografi. Ato maten me raportin aktual mes kandidatit dhe kohës në të cilën ai garon. Dhe pikërisht këtu duhet kërkuar shpjegimi kryesor.

Profili publik i gjeneral Çekut ka mbetur profil shtetari klasik: i përmbajtur, institucional, i qetë, i rezervuar. Ai nuk ka ndërtuar kurrë një prani të fortë mediatike, nuk ka kultivuar polemikë dhe nuk ka kërkuar protagonizëm. Ka besuar se puna dhe historia flasin vetë.

Por politika e sotme funksionon ndryshe. Ajo kërkon prani të vazhdueshme, komunikim të thjeshtuar, narrative personale dhe identifikim emocional të përditshëm me elektoratin. Në këtë realitet, edhe figurat e mëdha, nëse nuk komunikojnë në mënyrë aktive me kohën, rrezikojnë të mbeten jashtë ritmit.

Duhet thënë edhe diçka tjetër me sinjeritet: Gjeneral Agim Çeku kurrë nuk e ka ndërtuar veten si politikan klasik. Ai ka mbetur gjithmonë më shumë shtetar sesa politikan. Më shumë njeri i përgjegjës sesa i garës. Më shumë figurë e



funksionit sesa e fushatës.

Kjo është virtyt. Por në demokraci elektorale, kjo është edhe dobësi praktike.

Moszgjedhja e tij nuk është refuzim i veprës së tij. Është shenjë e një mospërputhjeje mes një profili të madh

shtetëror dhe një skene politike që sot kërkon profile të tjera.

Gjeneral Agim Çeku mbetet një figurë që i përket historisë së madhe të këtij vendi. Dhe historia e Kosovës nuk është shkruar dhe nuk do të shkruhet kurrë pa emrin e tij. Zgjedhjet

kalojnë. Biografisë e tilla mbesin.

Pyetja e vërtetë nuk është pse Agim Çeku nuk u bë deputet.

Pyetja është: a po di Kosova ta përdorë si duhet kapitalin e saj më të çmuar - njerëzit e saj të përvojës dhe të historisë?

AKTORI EDI KASTRATI DHE TEATRI 'HADI SHEHU' NË GJAKOVË NË MBËSHTETJE TË MARSHIT 'DREJTËSI, JO POLITIKË' MË 17 SHKURT

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

GJAKOVË, 28 JANAR - Platforma "Liria ka Emër" ka vazhduar fushatën e saj të takimeve dhe mobilizimit qytetar me një vizitë në qytetin e Gjakovës.

Përfaqësuesja e platformës, Eliza Hoxha, vizitoi Teatrin e Qytetit "Hadi Shehu", ku u takua me aktoren e njohur Edi Kastrati.

Gjatë takimit aktori Edi Kastrati shprehu mbështetjen e plotë për marshin "Drejtësi, jo politikë", i cili do të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë, në mbrojtje të drejtësisë së paanshme dhe të vlerave të luftës çlirimtare. "Me trup dhe me zemër e mbështesim këtë marsh. Kemi obligim moral, kombëtar, shtetëror dhe kulturor ta mbështesim këtë thirrje qytetare. Drejtësia nuk mund të jetë selektive dhe as e politizuar. Si artistë, kemi përgjegjësi të jemi në anën e së vërtetës dhe të dinjitetit të këtij vendi", ka thënë Kastrati.

Me këtë rast, mbështetje të plotë marshit i ka dhënë edhe e gjithë trupa artistike e Teatrit "Hadi Shehu", e cila u ka bërë thirrje qytetarëve të Gjakovës dhe më gjerë që të marrin pjesë masivisht në marshin e 17 shkurtit.

Përfaqësuesja e platformës, Eliza Hoxha, vlerësoi lart këtë mbështetje nga komuniteti artistik, duke theksuar rëndësinë e zërit kulturor në mbrojtje të drejtësisë: "Kur artistët ngrihen në mbrojtje të drejtësisë, kjo thirrje merr kuptim edhe më të thellë. Mbështetja e Teatrit 'Hadi Shehu' dhe e artistëve të Gjakovës është dëshmi se kjo kauzë i tejkalon kufijtë e politikës dhe i përket ndërgjegjes sonë kolektive", tha Hoxha.

Platforma "Liria ka Emër" do të vazhdojë takimet në qytete të ndryshme të Kosovës, duke ndërtuar një mobilizim të gjerë qytetar për marshin "Drejtësi, jo politikë", më 17 shkurt në Prishtinë.



Certifikohen 15 zyrtarë korrektues në Dubravë

PRISHTINË, 28 JANAR - Në Qendrën Korrektuese në Dubravë është realizuar certifikimi i 15 zyrtarëve korrektues të cilët kanë përfunduar me sukses

trajnimin për ndihmën e parë. Ky trajnim është zhvilluar në kuadër të programeve të rregullta të trajnimit të stafit dhe ka pasur për qëllim forcimin e njohurive bazë për

reagim të shpejtë në situata emergjente. Njohuri që janë të vlefshme si gjatë punës në institucion ashtu edhe jashtë tij.

Shërbimi Korrektues i Kosovës

vazhdon të jetë i përkushtuar në zhvillimin profesional dhe edukativ të stafit, duke investuar në trajnime që rrisin sigurinë, përgjegjësinë dhe cilësinë e shërbimit.



Ndahen mirënjohje për oficerët doganorë

PRISHTINË, 28 JANAR - Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Doganës, drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, ka ndarë mirënjohje për oficerët doganorë në kuadër të një iniciative vlerësuese, duke çmuar angazhimin, profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre të vazhdueshëm në kryerjen e detyrave zyrtare. Gjatë këtij aktiviteti u theksua se puna dhe kontributi i oficerëve doganorë janë thelbësore për

realizimin e misionit të Doganës së Kosovës, forcimin e sigurisë kufitare, parandalimin e veprimtarive të paligjshme dhe mbrojtjen e interesit publik. Drejtori i përgjithshëm i Doganës vlerësoi rolin e tyre të përditshëm në garantimin e sundimit të ligjit dhe funksionimin efikas të institucionit, duke nënvizuar se iniciativa të tilla synojnë jo vetëm njohjen e meritave, por edhe motivimin e mëtejme të stafit doganor për përmbushjen e përgjegjësiave me standarde të

larta profesionale. Në këtë kuadër, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Doganës 2026, e cila i kushtohet temës së përmbledhur në sloganin “Customs protecting society through vigilance and commitment”, Dogana e Kosovës u nderua me certifikatë mirënjohjeje për shërbim të jashtëzakonshëm ndaj komunitetit ndërkombëtar doganor, e nënshkruar nga sekretari i përgjithshëm i Organizatës Botërore të Doganave, Ian Saunders.



KOSOVA DHE SERBIA S'PËRFITOJNË NGA 171 MILIONË EUROT QË BE-ja NDAN PËR BALLKANIN

PRISHTINË, 28 JANAR - Komisioni Evropian ka njoftuar për mbështetje prej 171 milionë eurosh për nxitjen e zhvillimit të infrastrukturës dhe rritjes së sektorit privat në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, nga këto fonde nuk do të përfitojë Kosova, por as fqinja e saj veriore, Serbia. “Sa i përket Kosovës, ajo ende nuk ka përmbushur kushtet ligjore për të pranuar pagesa, pasi që ende nuk ka ratifikuar Marrëveshjen e Kredisë dhe Fondeve në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor. Prandaj, Kosova nuk mund të përfitojë nga fondet e këtij instrumenti. Ne shpresojmë se kjo çështje të zgjidhet shpejt”, tha për Radion Evropa e Lirë zëdhënësi i KE-së, Guillaume Mercier.

Kosova duhet të ratifikojë marrëveshjet për hua dhe fonde në kuadër të Planit të Rritjes pas formimit të institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet e 28 dhjetorit. Gjatë vitit 2025 kjo nuk mundi të ndodhë për shkak të bllokadës politike, e cila rezultoi në dy raunde zgjedhjesh parlamentare gjatë vitit të kaluar. Përveç Kosovës, as Serbia nuk është përfituese e këtyre fondeve. Por, arsyet për Serbinë janë të ndryshme.

Siç shpjegoi për Radion Evropa e Lirë një zëdhënësi i KE-së, për Serbinë nuk u miratuan projekte

nga Fondi për Reforma dhe Rritje, sepse në momentin e nisjes së procesit të miratimit, fondet nga Plan i Rritjes ende nuk ishin të disponueshme. Megjithatë, vendi pritet të marrë së shpejti miratimin për projektet. “Tani, kur Serbia ka marrë fonde shtesë nga Plan i Rritjes përmes pagesës së kështit të parë, projektet që Serbia i ka dorëzuar dhe që Komisioni i ka vlerësuar pozitivisht mund të dërgohen për miratim te Bordi Drejtues i Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor”, tha zëdhënësi i KE-së, Guillaume Mercier.

Nga shuma prej 171 milionë eurosh, e ndarë për nxitje të zhvillimit në Ballkanin Perëndimor, 94.7 milionë euro janë të dedikuara për investime infrastrukturore, 76.3 milionë euro për mbështetjen e sektorit privat, ndërsa 2.9 milionë euro janë ndarë për katër projekte të asistencës teknike në Shqipëri dhe Bosnjë-Hercegovinë.

Këto projekte janë të orientuara drejt përgatitjes së investimeve të ardhshme në sektorët e energjisë, furnizimit me ujë, inovacionit dhe kërkimit. Sipas njoftimit të KE-së, fondet e ndara për projektet infrastrukturore pritet të mobilizojnë gjithsej 263 milionë euro investime përmes shtatë projekteve në sektorë me prioritet, përfshirë digjitalizimin,



energjinë e pastër, kapitalin njerëzor, transportin dhe mbrojtjen e mjedisit.

Projektet përfshijnë vendosjen e infrastrukturës së internetit me brez të gjerë në Shqipëri, përmirësimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Maqedoninë e Veriut, si dhe ndërtimin dhe rinovimin efikas energjetik të objekteve arsimore në Maqedoni të Veriut dhe Mal të Zi. Sipas KE-së, projektet do të zbatohen nga partnerët e Ballkanit Perëndimor në bashkëpunim me

institucionet financiare ndërkombëtare. “Investimi te partnerët tanë në Ballkanin Perëndimor është thelbësor për afrimin e tyre me Bashkimin Evropian. Më shumë se dy vjet pas miratimit të Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, kemi punuar - përfshirë edhe përmes Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor - për t'i shndërruar zotimet në veprime konkrete. Nga përmirësimi i infrastrukturës deri te forcimi i zhvillimit të biznesit, këto investime krijojnë mundësi reale

për qytetarët dhe e bëjnë BE-në një realitet të prekshëm në mbarë rajonin”, tha përmes një deklarate komisionarja evropiane për Zgjerim, Marta Kos.

Paketa e re e mbështetjes përfshin kontribute investuese nga disa burime financimi të BE-së, përfshirë Instrumentin për Ndihmë të Para-Anëtarësimit (IPA), donatorët bilateralë përmes Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor, si dhe Instrumentin për Reforma dhe Rritje. “Paketa e sotme e financimit përfshin projekte investimi dhe projekte të asistencës teknike që u miratuan sot, duke forcuar më shumë përkushtimin e BE-së ndaj rritjes së qëndrueshme dhe ndërlidhjes rajonale në Ballkanin Perëndimor”, tha KE-ja.

Pas miratimit nga Bordi Operativ i Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor, projektet mund të kalojnë në fazën e zbatimit. Kjo nënkupton finalizimin e marrëveshjeve të nevojshme me institucionet partnere dhe përfituesit, nisjen e studimeve përgatitore për aktivitetet e asistencës teknike dhe përfundimin e procedurave të domosdoshme për realizimin e projekteve të sektorit privat. Pas përmbylljes së këtyre proceseve, mund të fillojë zbatimi i investimeve që mbështeten nga blloku.

ZKA-ja fillon auditimin e procesit të lejeve të ndërtimit në komunën e Ferizajt

PRISHTINË, 28 JANAR - Në vazhdim të zbatimit të Planit Vjetor të Auditimit 2025/2026, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka filluar auditimin e performancës “Efikasiteti dhe efektiviteti në procesin e ndërtimeve të larta në komunën e Ferizajt”, për periudhën 2021-2025.

Auditimi do ta vlerësojë efikasitetin dhe efektivitetin e procesit të dhënies së lejeve për ndërtime të larta në komunën e Ferizajt, duke filluar nga paraqitja e kërkesës për leje deri të lëshimi i certifikatës së përdorimit. Gjithashtu do të vlerësohet nëse mekanizmat ekzistues

sigurojnë transparencë dhe mbrojtje të interesit publik. Realizimi i këtij auditimi është vazhdimësi e auditimeve të ngjashme të realizuara më herët në komunën e Prishtinës dhe komunën e Fushë-Kosovës, qytete me zhvillim të hovshëm të ndërtimeve të larta.



CILI KA QENË VITI MË I RËNDËSISHËM NË HISTORI, DHE PSE

Historianë, gazetarë dhe shkrimtarë ofrojnë pikëpamjet e tyre mbi një pyetje që vazhdon të ndajë opinionet

Viti 1000 pas Krishtit: Fuqia nordike: kur përplaseshin botët

Ky moment është ndoshta i mbushur me simbolikën më globale. Ishte koha kur, sipas sagave të vjetra norvegjezo-islandeze, aventurierë nordikë lundruan përtej Atlantikut të Veriut, nga vendbanimet në bregun perëndimor të Groenlandës, deri në skajin e kontinentit të Amerikës së Veriut. Atje ata u takuan me banorët e zonave bregdetare të asaj që sot është Kanadaja: paraardhës të popujve si Beothukët dhe Algonkinët. Rrethi i njerëzimit u mbyll për herë të parë në historinë e regjistruar.

Në vitet 1960, arkeologët zbuluan një vendbanim dimërimi nordik në L'Anse aux Meadows, në skajin verior të Njufauldlandit. Kjo konfirmoi atë që sagat kishin përshkruar prej kohësh: një seri udhëtimesh drejt perëndimit nga Groenlanda, zbulimin e tokave dhe burimeve të reja, si dhe përplasje gjithnjë e më të dhunshme me popullsitë vendase, të cilat nordikët i quanin Skrælingar, një term fyes që do të thotë "të mjerë".

Këto takime ndërkulturore nisën me mjaft premtje, me

Histories of the Viking Age (Profile, 2024).

Viti 1066 / Pushtim, kështjella, ndryshime shoqërore dhe kalorësi

Për historinë britanike, të paktën, përgjigja është 1066. Kjo mund të duket befasisëse për ata që mbajnë mend vetëm Betejën e Hastings, vdekjen e mbretit Harold dhe ardhjen në pushtet të Uilliam Pushtuesit. Por ndryshimi i regjimit që pasoi pushtimin norman shkoi shumë më tej sesa thjesht zëvendësimi i një dinastie mbretërore.

Siç tregon Domesday Book, deri në vitin 1086 klasa e vjetër sunduese e Anglisë anglo-saksone ishte zëvendësuar pothuajse tërësisht dhe më shumë se 90 për qind e tokës ishte tashmë në duart e të ardhurve nga kontinenti evropian. Kjo pati një ndikim të menjëhershëm në pamjen fizike të vendit. U ndërtuan me qindra kështjella, teksa para vitit 1066 pothuajse nuk ekzistonin fare në Angli. Katedralet dhe abacitë u shembën dhe u rindërtuan në një



dhe ushquu kolonizimin agresiv anglez të këtyre vendeve në shekujt që pasuan.

Marc Morris është historian i Mesjetës, shkrimtar dhe komentator.

1945: Bota pas luftës botërore

Në shkallë globale, Lufta e Dytë Botërore ishte periudha më vendimtare në histori. Dhe si rrjedhojë, viti i përfundimit të saj ishte viti më i rëndësishëm.

Lista e transformimeve që ndodhën si pasojë e luftës është vërtet marramendëse. U shënuan përparime të mëdha në teknologjinë kompjuterike, radioteknologji, kërkime mbi plastikën, avionët reaktivë, shkencën e raketave dhe prodhimin e antibiotikëve. Energjia bërthamore shpërtheu në ndërgjegjen njerëzore në vitin 1945. Super Glue u zbulua gjatë luftës, po ashtu edhe teknologjia që qëndron pas furrave me mikrovalë. Dhe ishte fitorja përfundimtare e vitit 1945 që lejoi këto risi të dilnin nga fshehtësia e kohës së luftës dhe të hynin në botën civile.

Krahas teknologjive të reja erdhën edhe ndryshime të thella shoqërore dhe gjeopolitike. Ishte në vitin 1945 që harta e sotme

e Evropës u vizatua gjatë Konferencave të Jaltës dhe Potsdamit. Në të njëjtën kohë nisi marrja e pushtetit nga komunistët në Evropën Lindore. Ky ishte viti kur kombet e Azisë dhe Afrikës, të frymëzuara nga retorika e kohës së luftës, nisën shtytjen e tyre përfundimtare drejt dekolonizimit. Rendi ndërkombëtar u rilind me krijimin e Kombeve të Bashkuara, dhe më pas u ndërtua një rrjet i tërë organizatash të lidhura me të. Lista mund të vazhdojë pafund.

Lufta e Dytë Botërore hodhi një hije aq të gjatë mbi botën, sa ndikimi i saj ndihet edhe sot. Kujtesa e vitit 1945, dhe e gjithçkaje që ai përfaqëson, ruhet në kulturën tonë të rrëfimit, të kinemasë dhe të letërsisë, dhe vazhdon të përkujtohet çdo vit. Asnjë vit i vetëm në histori nuk ka pasur ndonjëherë një fuqi kaq të madhe mbi ne, dhe vështirë se ndonjë vit tjetër do ta ketë përsëri. Keith Lowe është autor i librit "The Fear and the Freedom: How the Second World War Changed Us".

31 p.e.s. Actiumi: kthesa që ndryshoi rrjedhën e historisë romake

Në mesditën e 2 shtatorit të vitit 31 para erës sonë, Markus Agripa ndodhej në bordin e anijes së tij

dhe vështronte drejt kepit grek të Actiumit. Rreth 60 anije luftarake të armikut po çanin me shpejtësi dallgët e Detit Jon, drejt flotës prej rreth 400 anijesh të drejtuara prej tij dhe Oktavianit, i cili po ndiqte betejën nga një pozicion i favorshëm në tokë. Anijet që po afroreshin ishin pjesë e flotës prej 230 anijesh të komanduar nga Mark Antoni, ish-aleati romak i Oktavianit, dhe Kleopatra, mbretëresha e Egjiptit.

Kur flotat u përplasën, anijet e Kleopatërës u futën drejt e në mes të vijës së betejës, dhe për një çast u duk sikur fati i luftës mund të ndryshonte.

Por ndodhi e kundërta. Anijet e saj çanë mospërmes betejës dhe dolën në det të hapur. Kleopatra po arratisej. I kapluar nga paniku, Mark Antoni braktisi anijen e tij dhe e ndoqi me disa mjete më të vogla, duke lënë pjesën tjetër të flotës përballë sulmit të pamëshirshëm. Pas kësaj, dorëzimi ishte i pashmangshëm.

Në kohën e betejës, Perandoria Romake ishte e ndarë: Oktaviani sundonte Perëndimin, ndërsa Mark Antoni Lindjen. Pas vetëvrasjeve të Kleopatërës dhe Mark Antonit në vitin 30 p.e.s., si pasojë e humbjes në Actium, Oktaviani u bë sundimtari i vetëm i Romës dhe pushtuesi i Egjiptit. Tre vjet më vonë, Senati Romak i dha atij titullin Augustus, duke shënuar zyrtarisht fundin e Republikës dhe fillimin e Perandorisë Romake.

Po të kishte fituar Antoni, qendra e Romës mund të ishte zhvendosur drejt Lindjes. Aleksandria mund të ishte bërë një kryeqytet i dytë; ambiciet romake ndoshta do të ishin orientuar nga Mesopotamia dhe Persia, e jo nga Germania dhe Britania; dhe sot Evropa mund të kishte një bazë gjuhësore greke, e jo latine.

Jess Venner është historiane e antikitetit, prezantuese dhe shkrimtare.



shkëmbime pëlhurash të kuqe dhe produkte bulmeti për lëkura kafshësh. Por, me kalimin e kohës, marrëdhëniet u shpërbënë prej mosbesimit, pati dhunë dhe vrasje, një paralajmërim i zymtë i asaj që do të vinte shekuj më vonë.

Sigurisht, ky është një moment që rëndësinë e ka fituar në retrospektivë. Ata udhëtarë nuk e kuptuan se kishin mbërritur në një kontinent krejtësisht të ri. Ekspeditat e tyre nuk bënë bujë në botë. Dhe pikërisht kjo, për mua, e bën këtë moment historik edhe më interesant. Sepse, kur jemi duke u bartur nga rrymat e vrullshme të kohës, nuk është gjithmonë e mundur të dallosh se cilat ngjarje dhe data do të kenë më shumë peshë për ata që do të kthejnë kokën pas.

Eleanor Barraclough është historiane, gazetarë dhe autore e librit Embers of the Hands: Hidden

stil të ri romanesk. Veriu i vendit u shtyp brutalisht për t'u nënshtruar dhe u shndërrua në një shkretëtirë. Më pak e dukshme, por edhe më e rëndësishme në planin afatgjatë, pushtimi solli edhe ide të reja për mënyrën se si duhej rregulluar shoqëria. Skllavëria, e cila kishte qenë e zakonshme mes anglo-saksonëve, u zhduk gjatë gjysmë shekullit që pasoi. Zakoni për t'ia kursyer jetën kundërshtarit të mundur u bë normë e re mes elitës sunduese.

Përvetësimi i shpejtë i këtyre qëndrimeve të reja nga anglezët i dalloj ata nga fqinjët e tyre ishullorë, të cilët vazhduan të masakronin armiqtë dhe ta praktikonin luftën si gjueti skllavërisht. Perceptimi i ri i uellsianëve, skocezëve dhe irlandezëve si barbarë të pacivilizuar ishte një pasojë e drejtpërdrejtë e pushtimit norman



1453: Mirupafshim Bizantinë, mirë se vini Osmanë

Sigurisht, është një detyrë e pamundur të zgjedhësh një vit të vetëm si më të rëndësishmin. Ngjarje madhore ndodhin, por ato bëhen të mundura nga ndryshime strukturore, politike, ekonomike, kulturore, që zhvillohen gjatë dekadave apo edhe shekujve. Megjithatë, po të duhej të zgjidhja, do të zgjidhja vitin 1453. Ishte viti kur përfundoi Lufta Njëqindvjeçare, por edhe, akoma më domethënëse, viti kur Konstantinopoja ra në duart e turqve osmanë. Kjo shënoi fundin e Perandorisë Bizantine, mbetja e fundit e botës romake, e cila kishte zgjatur për më shumë se 1 000 vjet. Qyteti u bë kryeqyteti i Perandorisë Osmane, e cila do të vazhdonte deri në vitin 1922 si një fuqi e madhe globale. Përbërja fetare e rajonit ndryshoi ndjeshëm, ndonëse ai mbeti një vatër përzierjeje popujsh me kultura dhe besime të ndryshme. Rënia e Kostandinopojës solli një valë studiuesish grekë drejt Evropës, të



cilët sollën dije të thella dhe ide të reja, duke i dhënë një shtysë të mëtejshme Rilindjes Evropiane. Ajo përfaqësoi gjithashtu një zhvendosje tektonike në gjeopolitikën globale, duke ndryshuar ekuilibrin e fuqive në Lindjen e Mesme dhe duke rikonfiguruar rrënjësisht rrugët tregtare midis Evropës dhe Azisë. Disa argumentojnë se vështirësitë në rritje të tregtisë përmes rrugëve tokësore në Euroazi nxitën eksplorimin evropian në Atlantik. Kjo kontribuoi gjithashtu në rikonfigurimin e tregtisë mesjetare të sklevërve. Meqë u bë më e vështirë për tregtarët evropianë të trafikonin njerëz përmes Detit të Zi, ata u drejtuan gjithnjë e më shumë nga bregdeti i Afrikës Perëndimore, duke nxitur rritjen e një prej fenomeneve më të tmerrshme dhe tragjike në historinë njerëzore. Hannah Skoda është profesoreshë e asociuar e historisë mesjetare në Universitetin e Oksfordit.

1858: Agimi i Epokës së Informacionit

Më 16 gusht 1858, Mbretëresha Viktoria i dërgoi një mesazh presidentit amerikan James Buchanan. Në rrethana normale, një komunikim i tillë do të kishte marrë rreth 10 ditë për të kaluar Atlantikun me anije, por ky mesazh mbërriti për vetëm 16 orë. Ai u dërgua për të shënuar lidhjen e

kabllit të parë telegrafik transatlantik, një linjë e drejtpërdrejtë mes Botës së Vjetër dhe Botës së Re. Lidhje më të shkurtra ishin realizuar tashmë mes Britanisë dhe Evropës kontinentale, përfshirë një linjë përmes Kanalit Anglez në vitin 1850, por Atlantiku paraqiste një sfidë shumë më të madhe. Për vite me radhë, inxhinierë, përfshirë Samuel Morse, kishin debatuar nëse ishte e mundur të shtrihej një kablo prej rreth 2,500 miljesh nën oqean. Përpjekja e parë, në vitin 1857, dështoi kur kabloja u këput. Por tani, më në fund, ajo u realizua. Disa komentatorë e shpallën si Mrekullinë e Tetë të Botës. Një gazetë e entuziazmuar në Boston njoftoi shkurt: “NUK KA MË DET!” Ky kablo i parë transatlantik u dëmtua pas vetëm tre javësh dhe vetëm në vitin 1866 u vendos një linjë e përhershme. Megjithatë, precedenti ishte vendosur: tani do të ishte e mundur të lidhej çdo cep i botës në një rrjet gjithnjë e më të gjerë kabllosh telegrafike, duke lejuar që sasi të mëdha informacioni të qarkullonin nëpër glob me shpejtësi të

paimaginueshme më parë. U deshën shumë vite që ky vizion të realizohej plotësisht, por në vitin 1858 shohim fillimin e Epokës së re të Informacionit, një moment qartësisht modern, që do të kulmonte më vonë me ardhjen e internetit. Bob Nicholson është shkrimtar, komentator dhe historian në Universitetin Edge Hill.

1917: Kur revolucioni riformësoi aleancat, identitetet dhe ambiciet

Në këtë vit kyç, Rusia u tërhoq nga Lufta e Parë Botërore, ndërsa Shtetet e Bashkuara hynë në të. Asnjëra prej tyre nuk konsiderohej ende një fuqi e madhe botërore, por veprimet e ndërmarra gjatë luftës nxitën transformime globale. Presidenti Woodrow Wilson, me



promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të demokracisë sipas modelit amerikan (universale në retorikë, por thellësisht e raciaizuar në praktikë), sinjalizoi ambiciet e SHBA-së për të dalë në skenën botërore. Megjithatë, historia kryesore ishte Rusia. Ekonomia e saj, e shkatërruar nga lufta, dhe popullsia e rraskapitur përmbysnë carin në mars (shkurt sipas kalendarit Julian që përdorej atëherë), duke hapur rrugën për marrjen e pushtetit nga bolshevikët në nëntor (tetor sipas kalendarit Julian). Revolucion i Rus, ngjarja më e rëndësishme e shekullit XX, u



përmbyll deri në fund të vitit 1917, ndërsa Bashkimi Sovjetik u konsolidua në vitin 1922. As lëvizja për të drejtat civile, as përpjekjet për dekolonizim nuk do të kishin marrë formën që njohim sot pa Bashkimin Sovjetik, qoftë si kundërshtar, qoftë si aleat. Në Shtetet e Bashkuara, për shembull, organizimi komunist dhe propaganda sovjetike i detyruan mbështetësit e segregacionit ose ta justifikonin, ose ta modifikonin sistemin e tyre të ndarjes racore.

Në botën e nënshtruar ndaj perandorive evropiane, komunizmi sovjetik ofroi burime intelektuale dhe materiale për nacionalistët antikolonialë. Historianët e Luftës së Ftohtë priren të përqendrohen te SHBA-ja në ngritje dhe rivali i saj sovjetik, që përplaseshin për hegjemoninë globale përmes konflikteve në Amerikën Latine, Afrikë dhe Azi. Por më domethënëse janë mënyrat se si modeli revolucionar dhe sfida revolucionare i shtynë komunitetet, grupet dhe kombet të artikulonin se kush ishin dhe kush dëshironin të bëheshin. Revolucion i Rus ndihmoi në rindërtimin e botës, dhe ne

vazhdojmë të jetojmë trashëgiminë e tij. Adriane Lentz-Smith është profesoreshë e asociuar e historisë në Universitetin Duke.

490 p.e.s. Maratona: një fitore për demokracinë


Gjashtë dekada pasi Kiri i Madh kishte themeluar Perandorinë Akamenide, forcat persiane të mbretit Dari I, po shtynin drejt

Perëndimit me synimin për të pushtuar të gjithë Greqinë. Qëllimi i tyre kryesor ishte shkatërrimi i Athinës, e cila kishte guxuar të mbështeste një kryengritje kundër perandorisë që, në atë kohë, kontrollonte pjesë të mëdha të rajonit. Por ata nuk e kishin llogaritur vendosmërinë dhe zgjuarsinë taktike të kundërshtarëve të tyre. Në shtator të vitit 490 p.e.s., flota persiane zbarkoi në bregun e Atikës, rreth 17 milje në verilindje të Athinës, dhe trupat e saj dolën në fushën e Maratonës. Rreth 10,000 burra athinas u mblodhën në kodrat përreth, të bashkuar nga 1,000 luftëtarë nga Platea, por edhe kështu ishin dukshëm më pak në numër.

Kur morën vesh se kalorësia persiane mungonte, luftëtarët grekë, të udhëhequr nga gjenerali athinas Miltiadihi, u hodhën në sulm kundër armikut. Kundër çdo pritshmërie, trupat persiane u thyen, thuhet se me koston e vetëm 192 të vrarëve athinas. Ky ishte një moment vendimtar në historinë e lashtë: u dha grekëve besimin se mund t'i bënin ballë Perandorisë së fuqishme Persiane dhe, falë rolit të tyre në fitore, athinasit dolën si polis-i më i rëndësishëm në Greqi. Njëkohësisht, kjo fitore i dha hov zhvillimit të demokracisë në Athinë.

Në mesin e shekullit XIX, filozofi anglez John Stuart Mill pohoi se “si një ngjarje në histori, Beteja e Maratonës ishte më e rëndësishme se Beteja e Hastings”, sepse fitorja e grekëve, dhe veçanërisht ajo e athinasve, ishte aq ngushtë e lidhur me zhvillimin e demokracisë. Michael Scott, profesor i klasikës dhe historisë së lashtë në Universitetin e Warwick-ut.





**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Konkurrencë e fortë për Fisnik Asllanin, Chelsea favorit

HOFFENHEIM, 28 JANAR - Ekipi nga Premier League, Chelsea, po shihet favorite për transferimin e sulmuesit të Kombëtares së Kosovës, Fisnik Asllani. Është bërë me dije se Chelsea ka njoftuar Hoffenheimin se

është gati të ofrojë të paktën 30 milionë euro për kartonin e Asllanit, të cilin po e sheh si përforcim ideal për sulmin. Chelsea është ekipi i fundit që është futur në garë për Asllanin, të cilin po e synojnë edhe Barcelona, Juventus, Bayern

Muncheni, Tottenhami, Borussia Dortmundi e disa skuadra tjera. 23-vjeçari ka kontratë me Hoffenheimin deri në vitin 2029 dhe një klauzolë lirimi në vlerë prej 30 milionë eurosh, ndërsa në sezonin e tij të parë në Bundesligë, Asllani

ka shpërthyer. Në 18 ndeshje kampionale, Asllani ka shënuar 6 gola dhe ka bërë 4 asistime kurse në total, sulmuesi "dardan" ka 7 gola e 5 asistime në 20 paraqitje për Hoffenheimin në të gjitha garat.



NË PRAG TË SHORTIT TË LIGËS SË KOMBEVE, UEFA TREGON SE KOSOVËS I NDALOHET TË LUAJË KUNDËR BOSNJË-HERCEGOVINËS

PRISHTINË, 28 JANAR - Në prag të shortit të Ligës së Kombeve për sezonin 2026/27, UEFA ka dalë me një sqarim rreth situatës së kombëtares së Kosovës. Kombëtarja dardane ka siguruar kualifikimin për Ligën B të Ligës së Kombeve, pasi ka fituar në "play-off" ndaj Islandës në muajin mars të vitit të kaluar. Kosova ishte pjesë e Ligës C dhe kishte përfunduar e dyta, në një grup me Rumaninë,

Qipron dhe Lituaninë, duke marrë 12 pikë nga gjashtë ndeshje. Shorti për Ligën e Kombeve të sivjetme do të mbahet më 12 shkurt 2026 në Bruksel të Belgjikës, pjesë e të cilit është edhe Kombëtarja e Kosovës si pjesë e Ligës B. Në Ligën B është edhe Bosnjë-Hercegovina, kundërshtarë që Kosova nuk mund ta ketë, shkaku i rregullave të UEFA-s. UEFA e ka sqaruar situatën e

Kosovës dhe Bosnjës përmes një njoftimi zyrtar. "Bazuar në vendimet e Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s, të vlefshme në kohën e hedhjes së shortit, ekipet që nuk mund të jenë në një grup, janë: Bosnjë-Hercegovina (Liga B, vazo 2) - Kosova (Liga B, vazo 4). Përballjet e tjera të ndaluara nuk mund të ndodhin për shkak se ekipet përkatëse nuk luajnë në të njëjtën ligë", ka njoftuar UEFA.



SHQIPËRIA E PARAFUNDIT NË EVROPË PËR FUSHAT E FUTBOLLIT, PESË HERË MË KEQ SE MESATARJA

TIRANË, 28 JANAR - Ndërsa shkëlqimi i Euro 2024 ende nuk është zbehur dhe fanellat kuqezi shiten masivisht, kjo edhe sepse ne presim të jemi mes më të mirëve të Botës, duke provuar nëpërmjet "play-off"-it të marsit, përballë Polonisë. "Top Channel" ka siguruar një raport studimor konfidencial të UEFA-s që tregon një të vërtetë të dhimbshme për Shqipërinë. Pas fasadës së stadiumeve moderne, fshihet një shkretëtirë infrastrukturore që rrezikon të thajë burimin e talenteve. Shqipëria renditet në vendin e 53-të, nga 55 anëtare të UEFA-s, në Evropë për numrin e fushave në raport me popullsinë. Por, çfarë fshihet pas këtyre numrave dhe pse "projekti i 100 fushave"



ka mbetur peng i betonit? Raporti i UEFA-s për infrastrukturën bazë është një aktakuzë e hapur për menaxhimin e investimeve të qeverisë dhe projekteve të saj në infrastrukturën sportive. Shifra kryesore është alarmante: Një fushë futbollit (11x11) në Shqipëri duhet të përballojë një popullsi prej 18 981 banorësh. Për ta kuptuar më mirë këtë shifër, mund të themi se

mesatarja e UEFA-s apo Evropës në përgjithësi është 3 800 banorë për fushë, që do të thotë se Shqipëria është rreth 5 herë më keq. Vendet e ngjashme në raportin popullsi/ekonomi janë në shifrat e 5 400 banorëve për fushë dhe prapë Shqipëria është 3.5 herë më keq. Ndërsa vendet nordike si Islanda apo Norvegjia, kanë më pak se 1 500 banorë/fushë. Kjo do të thotë se statistikisht, një fëmijë shqiptar ka 500 për qind më pak shanse për të prekur topin në një fushë standarde sesa një bashkëmoshatar i tij në Evropën Qendrore. Kjo "mungesë aksesi" përkethehet direkt në ulje të pjesëmarrjes. Futbolli nuk është më sporti i

popullit sepse po kthehet në sportin e atyre që kanë mundësi të paguajnë akademitë private ose të udhëtojnë larg qendrave urbane. Edhe iniciativa e institucionit të futbollit në bashkëpunim me UEFA-n për të ndërtuar 100 fusha shpesh ka hasur vështirësi bashkëpunimi me pushtetin lokal, kryesisht në bashkitë e mëdha si Tirana apo Durrësi. Ato e kanë të pamundur për të mos thënë që nuk kanë vullnet, të gjejnë hapësira të lira brenda zonave urbane. Për një bashki, një parcelë toke ka më shumë vlerë si shesh ndërtimi për kulla që sjell taksa ndikimi në infrastrukturë sesa si fushë futbollit që sjell kosto mirëmbajtjeje.

Fushat e reja që po ndërtohen janë të detyruara të zhvendosen në periferi ekstreme, zonat rurale, ish-këneta, apo fshatra. Ekonomia e futbollit sot është industri miliardash, por ne kemi dështuar të krijojmë "fabrikat" që janë fushat në këtë rast. Një ndër zgjidhjet mund të jetë ndërhyrja legjislative që detyron planifikimin urban të përfshijë koeficientë të detyrueshëm për sipërfaqe sportive për çdo numër të caktuar banorësh. Nëse nuk rikthejmë fushat në qytet, ose të paktën transportin e dedikuar drejt periferive, futbolli shqiptar do të mbetet një "konsumator" talentesh të huaja, në pamundësi për të qenë "prodhues" i talenteve të veta.

DY SKUADRA ITALIANE INTERESOHEN PËR MARASH KUMBULLËN



MALLORCA, 28 JANAR - Në ditët e fundit të merkatos së janarit në medie po qarkullon fuqishëm emri i Marash Kumbullës, pasi në radhët e Mallorcas nuk janë të kënaqur me rendimentin e tij e po kërkojnë të ndërpresin përpara kohe periudhën e

huazimit. Sipas "Sky Sport", interesim për qendërmbrojtësin kuqezi ka shfaqur jo vetëm Udinese, por së fundmi informacione po kërkon edhe Torino. Dëmtimi i Ismajlit, i cili pritet të qëndrojë jashtë fushës së lojës për të paktën një muaj, detyron

Torinon të shohë në treg për një tjetër operacion, sigurisht me kosto të ulët. Kumbulla shihet si profili ideal, një lojtar që e njeh shumë mirë Serinë A pasi është në pronësi të Romës, skuadër me të cilën është aktivizuar në 68 ndeshje dhe ka shënuar 4 gola. Kumbulla

ka qenë pjesë edhe e Hellas Verona, skuadër ku u bë i njohur, ndërsa për një sezon kaloi në huazim edhe te Sassuolo. Në çdo aspekt, Kumbulla përfaqëson një okazion të vërtetë dhe dëshira e palëve, e lojtarit dhe Romës, është të rikthehen në Serinë A.

FShF-ja siguron 4 500 bileta për ndeshjen Poloni - Shqipëri

TIRANË, 28 JANAR - Federata Shqiptare e Futbollit (FShF) ka siguruar 4 500 bileta për tifozët shqiptarë në ndeshjen

Poloni - Shqipëri, e vlefshme për "play-off" të kualifikimeve të Botërorit 2026. Sipas gazetarit Kristi Sejtllari,

FShF-ja ka siguruar më shumë se 5 për qind të kapacitetit derisa është duke punuar të arrijë të sigurojë deri në 20 për

qind të stadiumit që i bie 10 mijë bileta, edhe pse sipas gazetarit kjo është shumë e vështirë për t'u arritur.





N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com



Në bazë të dispozitave të nenit 21, pikës 21.4 të Ligjit nr. 03/L- 087 Për Ndërmarrjet Publike, gjegjësisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 17 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me datë 27.01.2026 bazuar mbi Vendimin nr. 1/114, publikon këtë:

KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e një (1) pozite

1. Titulli i punës: Kryeshef/e Ekzekutiv/e
Vendi: Prishtinë.

Ndërmarrja: N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve.
Mandati: 3 vite
Koeficienti: 7

2. Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve, dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t'i përmbushë edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale në vijim:

- Të ketë diplomë universitare në fushat ekonomike, juridike, teknike apo në fusha të tjera të ndërlidhura me aktivitetet, në të cilat vepron ndërmarrja;
- Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë – së paku në një nivel të lartë menaxhmentit –në fushën e administrimit të biznesit,financave korporative,financa,menaxhim i thesarit,banka,konsulencë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së ose (ii) për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik , jurist I kualifikuar , ose anëtarë i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së;
- Të ketë shkathtësi organizative, drejtuese dhe aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit;
- Të ketë shkathtësi të nevojshme në punën me kompjuter, për punën dhe detyrat e punës;

- Njohuria e gjuhës angleze është e preferuar;
- Dëshmitë mbi njohuritë dhe të arriturat tjera do të mirren në konsideratë dhe vlerësohen konform relevancës me vendin e punës;
- Të jetë person me integritet të lartë dhe të plotësoj të gjitha kushtet e përshtatshmërisë të parapara me neni 17 të Ligjit të Ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 , dhe plotësim ndryshimet përkatëse,Ligji për Parandalimin e konfliktit të interes në ushtrimin e funksionit public nr/06L-011, si dhe me normat tjera positive relevante.

3.Kryeshefi/e Ekzekutiv/e ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Lidhë kontratë për Ndërmarrjen, në pajtueshmëri me ligjin, Statutin dhe aktet tjera qeverisëse, përjashtuar rastet e parapara me dispozitat e Nenit 192 (192.1 pika c) të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
- Menaxhon politika dhe zbaton vendimet e Bordit të Drejtorëve në pajtim me legjislacionin në fuqi si dhe kryen të gjitha punët dhe përgjegjësitë në pajtim me legjislacionin dhe aktet normative të aplikueshme të NP;
- Është njëri nga anëtarët e bordit me të drejta të plota bazuar në ligjet në fuqi;
- Këshillon dhe asiston Bordin e Drejtorëve në përcaktimin e strategjisë së Ndërmarrjes si dhe planet e saja strategjike afatgjata;
- Dorëzon, sipas përgjegjësi të tij Bordit të Drejtorëve drafte të dokumenteve që parashikohen sipas legjislacionit në fuqi;
- Ofron kurdo që të jetë e nevojshme, dhe së paku një herë në tre muaj, Bordit të Drejtorëve raporte për transaksionet kryesore të ndërmarrja nga Ndërmarrja dhe për vendimet kryesore të ndërmarrja nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe të punëve të Ndërmarrjes;
- Dorëzon, nën përgjegjësinë e tij/saj, Bordit të Drejtorëve dokumente, letra dhe informacione në lidhje me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e mbledhjeve të tij;
- I propozon Bordit të Drejtorëve indikatorë adekuat për matjen e performancës së Ndërmarrjes, si dhe t'i ofrojë Bordit rregullisht - së paku çdo tre muaj raportet e matjes së performancës së Ndërmarrjes kundrejt indikatorëve të tillë;
- Me aprovimin e Bordit, themelon dhe rishikon strukturën organizative të Ndërmarrjes, alokimin e fuqisë vendim-marrëse të Ndërmarrjes si dhe të fuqisë së ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të të punësuarve në Ndërmarrje me qëllim të arritjes së objektivave strategjike;
- Është i autorizuar të nënshkruaj kontratat dhe pagesat e aprovuara deri në limitin e përshkruar nga Bordi;
- Vepron si zyrtar kryesor administrativ i kompanisë;
- Është mbikqyrës dhe përgjegjës për organizmin e Ndërmarrjes në pajtueshmëri me statutin dhe aktet tjera të kompanisë dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve.
- Kryen të gjitha çështjet në lidhje me biznesin e Ndërmarrjes të cilat nuk janë në kompetencë të Komisioni Komunal të Aksionarëve, Bordit të Drejtorëve apo Komitetit të Auditimit/Zyrtari i Auditimit të Brendshëm;
- Në përputhje me legjislacionin dhe aktet e brendshme, punëson ose largon nga puna zyrtarët dhe stafin e kompanisë, përveç zyrtarëve të zgjedhur nga Bordi i Drejtorëve ose Komiteti i Auditimit.
- Krijon kulturë korporative e cila ndihmon në tërheqjen, mbajtjen dhe motivimin e të punësuarve në të gjitha nivelet;

- Sigurohet që Ndërmarrja të mbajë standarde të larta të etikës dhe përgjegjësisë në raport me legjislacionin në fuqi;
- KË ka të drejtë ekskluzive për të ndërprerë marrëdhënien e punës së një anëtarit nga kabineti i tij/saj i cili ka dështuar në përmbushjen e rregullave ose standardeve të Ndërmarrjes;
- Kryeshefi Ekzekutiv disa prej kompetencave të tij mund t'ia delegojë Udhëheqësve të departamenteve, kabinetit të tij apo personave të veçantë kundrejt një autorizimi me shkrim;
- Autorizon dikë nga zyrtarët e lartë të ndërmarrjes që të zëvendësojë dhe të mbajë vulën e Ndërmarrjes në përputhje me Ligjin 03/L-054 për vulat në Kosovë.

4. Informatë për procedurën e konkurimit

- Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
- Formulari i kërkesës për punësim (aplikimit);
- Kopje e letërnjoftimit;
- CV;
- Letër motivimi;
- Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin profesional e noterizuar;
- Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të notrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvoja të punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP e cila mund të shkarkohet nga uebfaqja e Kompanisë;
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

5. Afati i Konkursit:

Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data **27.01.2026 deri me datën 25.02.2026**.

Të interesuarit mund t'i dorëzojnë kërkesat (aplikacionet) e tyre me dokumentet tjera relevante në emailin: contact@pallatirinise.com

Formulari për kërkesë (aplikim) dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga ueb-faqja e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë në <http://www.pallatirinise.com/> ose mund të merren në zyrat e Ndërmarrjes.

6. Vërejtje:

Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurimit, do të refuzohen.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.

3

“Palma” SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 810679417, Gjilan me pronar Ekrem Shahini bënë shpallje në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 1759953.92 Euro në 4000 Euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Zahrije Makshana shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Vëllezërit Frashëri” Drenovc Rahovec nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Rexhep Rexhepishpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Zenel Sadiku” Babaj Bokes Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Beqir Deva shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Automekanik në Gjakovë.

- Dafina Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e vitit XI , XII shme “ Ymer Prizreni” Prizren.

- Nazmi Krasniqi shpall të pavlefshme certifikatën QK “11 Marsi” Prizren.

- Mesude Dogani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmua “Mati Logoreci” Prizren.

“FAR” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810155722.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Na osnovu odredbi člana 21, tačke 21.4 Zakona br. 03/L-087 o Javnim preduzećima, odnosno člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-087 o Javnim preduzećima, kao i na osnovu člana 17 Statuta, Upravni odbor J.P.K. PALATA OMLADINE A.D., dana 27.01.2026. godine, na osnovu Odluke br. 1/114, objavljuje:

JAVNI KONKURS
za popunu jednog (1) radnog mesta
1. Naziv radnog mesta:

1. Glavni/na Izvršni/a Direktor/ka

Mesto rada: Priština

Preduzeće: J.P.K. PALATA OMLADINE A.D. sa sedištem u Prištini

Odgovara: Upravnom odboru

Mandat: 3 (tri) godine

Koeficijent: 7

2. Uslovi i tražene kvalifikacije:

Upravni odbor želi da obezbedi da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju uslove kvalifikacije u skladu sa članom 17.1, ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l), da nisu i da u periodu od trideset šest (36) meseci pre datuma prijave nisu bili članovi Upravnog odbora predmetnog preduzeća, kao i da poseduju potrebno profesionalno iskustvo i obrazovanje za navedenu poziciju.

Kandidati moraju ispunjavati sledeće profesionalne uslove:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, prava, tehnike ili drugih oblasti povezanih sa delatnošću preduzeća;
- Najmanje pet (5) godina radnog iskustva, od čega najmanje na višem menadžerskom nivou, u oblasti upravljanja poslovanjem, korporativnih finansija, finansija, upravljanja trezorom, bankarstva, poslovnog konsaltinga ili industrije, ili najmanje pet (5) godina kao ovlašćeni računovođa, kvalifikovani pravnik ili član druge kvalifikovane profesije blisko povezane sa poslovanjem JP;
- Izražene organizacione i rukovodeće sposobnosti, kao i odlične komunikacione veštine;
- Neophodne veštine rada na računaru;
- Poznavanje engleskog jezika je poželjno;
- Dokazi o drugim znanjima i postignućima biće razmatrani u skladu sa relevantnošću za radno mesto;
- Visok lični integritet i ispunjavanje svih zakonskih uslova u skladu sa članom 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, njegovim izmenama i dopunama, Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javne funkcije br. 06/L-011, kao i ostalim relevantnim propisima.

3. Dužnosti i odgovornosti Glavnog Izvršnog Direktora:

- Zaključuje ugovore u ime Preduzeća u skladu sa zakonom, Statutom i drugim važećim aktima, osim u slučajevima predviđenim članom 192 Zakona o trgovinskim društvima;
- Upravlja politikama i sprovodi odluke Upravnog odbora u skladu sa važećim zakonodavstvom;
- Član je Upravnog odbora sa punim pravima u skladu sa zakonom;
- Savetuje i pomaže Upravnom odboru u definisanju strategije i dugoročnih planova Preduzeća;
- Dostavlja Upravnom odboru nacрте dokumenata u skladu sa zakonskim obavezama;
- Najmanje jednom u tri meseca podnosi izveštaje o glavnim transakcijama i odlukama menadžmenta;
- Predlaže pokazatelje za merenje performansi i redovno izveštava o njima;
- Uz saglasnost Odbora, uspostavlja i revidira organizacionu strukturu Preduzeća;
- Ovlašćen je za potpisivanje ugovora i isplata do limita koji odredi Upravni odbor;
- Deluje kao glavni administrativni rukovodilac Preduzeća;
- Odgovoran je za zakonito funkcionisanje Preduzeća;
- Zapošljava i razrešava zaposlene u skladu sa zakonima i internim aktima;
- Razvija korporativnu kulturu i obezbeđuje visoke etičke standarde;
- Može delegirati ovlašćenja uz pismeno odobrenje;
- Ovlašćuje službena lica za korišćenje pečata Preduzeća u skladu sa zakonom.

4. Informacije o proceduri prijave:

Zainteresovani kandidati moraju dostaviti sledeću dokumentaciju:

- Popunjen obrazac za prijavu;
- Kopiju lične karte;
- CV;
- Motivaciono pismo;
- Overene dokaze o obrazovanju i stručnim kvalifikacijama;
- Nostrifikovane diplome za obrazovanje stečeno u inostranstvu;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Izvod o penzijskim doprinosima (ako je primenljivo);
- Izjavu pod zakletvom u skladu sa Zakonom o JP;
- Uverenje suda da se protiv kandidata ne vodi krivični postupak (ne starije od 6 meseci);
- Spisak dostavljene dokumentacije.

4. Informacije o proceduri prijave:

Zainteresovani kandidati moraju dostaviti sledeću dokumentaciju:

- Popunjen obrazac za prijavu;
- Kopiju lične karte;
- CV;
- Motivaciono pismo;
- Overene dokaze o obrazovanju i stručnim kvalifikacijama;
- Nostrifikovane diplome za obrazovanje stečeno u inostranstvu;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Izvod o penzijskim doprinosima (ako je primenljivo);
- Izjavu pod zakletvom u skladu sa Zakonom o JP;
- Uverenje suda da se protiv kandidata ne vodi krivični postupak (ne starije od 6 meseci);
- Spisak dostavljene dokumentacije.

5. Rok za konkurs:

Javni konkurs je otvoren u periodu od 30 (trideset) kalendarskih dana od 27.01.2026. do 25.02.2026.

Zainteresovana lica mogu podneti svoje zahteve (prijave) sa ostalom relevantnom dokumentacijom na imejl adresu: contact@pallatirinise.com

Obrazac zahteva (prijave) i izjava pod zakletvom mogu se preuzeti sa veb stranice N.P.L. PALATI I RINISE J.A. sa sedištem u Prištini na

<http://www.pallatirinise.com/> mogu dobiti u kancelarijama preduzeća.

6. Napomena:

Kandidati sa nepotpunom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van roka za konkurs biće odbijeni.

Kontaktiraće se samo kandidati koji ispunjavaju navedene kriterijume i budu uvršteni u uži izbor.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Ermbotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L